



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

Komuna e Klinës, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Z. Zenun Elezaj

dhe

OJQ Let's Do It Peja, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Urim Xharavina

Neni 1

Sfondi

- 1.1. Ky Memorandum Bashkëpunimi përcakton termat për mirëkuptim, bashkëpunim midis **Komunës së Klinës dhe Let's Do It Peja – LDIP** për të punuar së bashku në zbatimin e projektit **“Të Bashkuar për Ajër të Pastër”**.
- 1.2. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë angazhimin afatgjatë duke u dhënë qytetarëve zërin që të ndikojnë në reformat e sektorit publik përmes programeve të bazuara në prova, analiza, monitorime, dhe iniciativa konkrete të avokimit në përmirësimin e cilësisë së ajrit në Komunën e Istogut, Gjakovës, Pejës, Deçanit dhe Klinës.
- 1.3. Objektivat specifike të projektit janë:
 - Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe ulja e ndotësve kryesorë të ajrit në komunat e rajonit të Istogut, Gjakovës, Pejës, Deçanit dhe Klinës.
 - Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në fushata avokuese për përmirësimin e cilësisë së ajrit;
 - Vetëdijesimi i bizneseve për instalimin e filtrave kundër ndotjes së ajrit.
- 1.4. Aktivitetet kryesore të projektit janë:
 - Identifikimi i ndotësve kryesorë të ajrit në ambiente jashtme dhe monitorimi i aktivitetit të tyre;
 - Monitorimi i cilësisë së ajrit në qytet dhe raportimi i gjendjes;
 - Ngritja e kapaciteteve të autoriteteve lokale për aplikimin e praktikave më të mira për ruajtjen e cilësisë së ajrit;

- Ngritja e kapaciteteve të sektorit privat për aplikimin e praktikave më të mira për ruajtjen e cilësisë së ajrit;
- Sensibilizimi i qytetarëve për të avokuar për ruajtjen e cilësisë së ajrit;
- Hartimi/Përditësimi i politikave lokale për cilësinë e ajrit;
- Hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësinë e Ajrit;
- Aktivizimi i komitetit për mbikëqyrjen lokale të cilësisë së ajrit;
- Organizimi i aktiviteteve për pastrim dhe gjelbërim;
- Angazhimi i qytetarëve në praktikat për përmirësimin e cilësisë së ajrit ;
- Hulumtimi dhe vlerësimi i rrezikut shëndetësor që lidhet me ekspozimin ndaj ndotjes së ajrit për rajonin e Istogut, Gjakovës, Pejës, Deçanit dhe Klinës.

1.5. Projekti “**Të Bashkuar për Ajër të Pastër**” zbatohet duke filluar me datë 01/01/2023 dhe përfundon me 1/12/2023, dhe është vazhdimësi e po të njëjtit projekt i cili me sukses ka përfunduar për dy vite me radhë zbatimin e projektit (2021 dhe 2022).

Neni 2

Financimi

- 2.1.** Projekti financohet nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë në vlerë prej 60,000EUR, Komuna e Pejës 5000 EUR, Komuna e Gjakoves me 5000 EUR, **Komuna e Klinës me 1000 EUR**, Komuna e Deçanit me 2500 EUR dhe Komuna e Istogut me 2500 EUR.
- 2.2.** Komuna e Klinës do të realizojë bashkëfinancimin me vlerë **1000 EUR** dhe do të realizohet menjëherë pas nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit.

Neni 3

Përgjegjësitë e palëve

- 3.1.** Monitorimin dhe hartëzimin e përbashkët të ndotësve kryesor në Komunën e Klinës.
- 3.2.** Lejoj zbatimin e aktiviteteve edukative vetëdijësuese në shkollat e Komunës së Klinës.
- 3.3.** Shkëmbimi i informacioneve dhe të dhënave statistikore për bizneset ndotëse në Komunën e Klinës.
- 3.4.** Krijimin e Komitetit konsultativ për Mbikëqyrjen e Cilësisë së Ajrit, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të Asamblesë Komunale, përfaqësues të drejtorive Komunale, përfaqësuesve të shoqërisë civile, qytetarë, etj; për ngrijën e kapaciteteve të tyre, hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Cilësi të Ajrit dhe dokumenteve tjera relevante dhe miratimin e dokumenteve të hartuara në Kuvend Komunal.
- 3.5** LDIP është përgjegjëse për zhvillimin dhe menaxhimin e gjithë procesit, nga zhvillimi i procedurave transparente dhe të drejtën për përcaktimin e termave të referencës dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të projektit, deri në dorëzimin përfundimtar të drafteve dhe raporteve si dhe pranimin dhe aprovimin nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë.
- 3.6.** LDIP është përgjegjëse për menaxhimin e tërësishëm financiar sipas procedurave të Komisionit Evropian-PRAG.
- 3.7.** Komuna e Klinës është përgjegjëse të bashkëpunoj me organizatën në përmbushjen e objektivave të projektit.
- 3.8.** Komuna e Klinës obligohet të kontribuoj në bashkëfinancimit të projektit me shumë prej 1000EUR.

3.9. Komuna e Klinës është përgjegjëse për formimin e grupit konsultativ i cili do të bashkëpunoj ngushtë me organizatën Let's Do It Peja në zhvillimin e aktiviteteve dhe hartimin e dokumentave të parapara në projekt

3.10. LDIP obligohet të raportoj në Komunën e Klinës për shumën e bashkëfinancimit.

Neni 4

Hyrja në fuqi

4.1 Ky memorandum do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të Komunës së Klinës dhe LDIP.

4.2 Ky memorandum mund të modifikohet me pëlqimin e ndërsjellë të përfaqësuesve të autorizuar nga Komuna e Klinës dhe LDIP nëse shprehet nevoja.

Neni 5

Përmbyllja e memorandumit të bashkëpunimit

5.1 Memorandumi i bashkëpunimit në mes të Komunës së Klinës dhe LDIP do të përmbillet në tërësi, pas miratimit të raportit përfundimtar nga Bashkimi Evropian, ku LDIP siguron përfundimin e plotë të aktiviteteve të parapara.

Palët nënshkruese

Zenun Elezaj

Kryetar i Komunës së Klinës



Urim Xharavina

Drejtore Ekzekutive të LDIP

